



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 017

Prishtinë, më 29 prill 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
29 PRILL 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Grupi Parlamentar i AKR-së ka parashtruar kërkesë me shkrim që Kuvendi të nxjerrë Rezolutë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, të cilën Kryesia, në mbledhjen e sotme, e ka mbështetur dhe kërkon nga grupet parlamentare, që gjatë ditës ta harmonizojnë tekstin e Projekt-Rezolutës.

Gjithashtu, Kryesia, në mbledhjen e sotme ka shqyrtuar kërkesën e deputetit Berat Luzha, të mbështetur edhe nga pesë deputetë të tjerë, për nxjerrjen e një deklarate kundër akuzave të Carla del Ponte, që e ka bërë ndaj UÇK-së, dhe ka vendosur që të shtyhet për seancën e radhës.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance me arsyetimin se kjo materie duhet të rregullohet në tërësi, e jo në mënyrë parciale, siç parashihet me këtë projektligj.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për: shumica absolute,
Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance për t'u rishqyrtuar nga ana e komisionit funksional.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi pikat 6, 9 dhe 10 të radhiten pas pikës së dytë – koha për pyetje parlamentare, me arsyetimin e ministrit Nekibe Kelmendi është e pranishme në pjesën e parë të seancës, kurse më vonë ajo ka detyrime të tjera

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për: shumica absolute,
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 17 prill 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën e vendosjes,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës,
10. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të AKR-së për ndërrimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji,
11. Shqyrtimi i propozimit të Grupi Parlamentar i AKR-së për nxjerrjen e Rezolutës kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 17 prill 2008

Deputeti Naser Rugova pati vërejtje në faqen e 7-të të procesverbalit ku gabimisht ishte evidencuar emri i Jonuz Salihaj në vend të deputetit **Adem Salihaj**, i cili kishte diskutuar gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndërmjetësim.

Deputeti Fatmir Rexhepi propozoi që në faqen e 3-të të transkriptit, në diskutimin e tij lidhur me nxjerrjen e një rezolute kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, pas fjalisë:” Në mënyrë që të mos kemi cenim të sovranitetit dhe të integritetit të vendit tonë”, në vazhdim të shtohet edhe kjo fjali:” **Qeveria dhe UNMIK-u të veprojnë në pajtim me detyrimet dhe mandatet që u takojnë**”.

Kryetari hodhi në votim miratimin e procesverbalit të seancës plenare të 17 prillit 2008. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për: gjithë deputetët e pranishëm,
Kundër -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 17 prill 2008 me plotësimet e cekura më lart.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ibrahim Makolli** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me vuajtjen e dënimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës në vende të tjera, që janë dënuar për vepra të ndryshme, si dhe për veprimet e kësaj ministrie që të dënuarve t’u mundësohet vuajtja e dënimit në vendin e origjinës.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Makolli.

Deputetja **Rita Hajzeraj** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me qëndrimin e Qeverisë për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për ta zvogëluar shkallën e lartë të vdekshmërisë së foshnjave.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Hajdin Abazi** i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me mundësitë financiare të kësaj ministrie për rregullimin e shtratit të lumit Nerodime dhe ruajtjen e bifurkacionit në komunën e Ferizajt.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Abazi.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë për veprimet e kësaj ministrie lidhur me privatizimin e Banjës afër Pejës nga ana e AKM-së.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** i parashtroi pyetje zëvendësministrit lidhur me atë se si do ta bëjë Qeveria e Kosovës koordinimin me Qeverinë e Rusisë rreth ndihmave humanitare për serbët e Kosovës?

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylja.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me qëndrimin e Qeverisë për ekstra profitin e kompanive publike (PTK-ja, KEK-u, Aeroporti etj.) që e realizojnë në bazë të monopolit në treg.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Myrvete Patina** i parashtroi dy pyetje: Pyetja e parë lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për subvencionimin e prodhimeve bujqësore të vendit për vitin 2008, kurse pyetja e dytë kishte të bënte lidhur me atë se çka ka ndërmarrë Qeveria për pajisjen e punëtorëve me librezë të punës?

Pyetjes së parë të deputetes Patina iu përgjigj ministri i Bujqësisë, **Idriz Vehapi**, kurse asaj të dytës iu përgjigj zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë: Çka ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e Ligjit për duhanin?

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Esat Brajshori** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për ta ushtruar autoritetin e saj, pas 17 shkurtit 2008, për t'iu shmangur rreziqeve eventuale për tkurrjen e tërësisë territoriale të Kosovës në Mitrovicë, Debëllde dhe në fshatrat e Anamoravës.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Brajshori.

Deputeti **Ismet Beqiri** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me Memorandumin e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës, UNMIK-ut dhe Qeverisë së Serbisë për ndërtimin e 70 shtëpive për serbët në Badoc të Prishtinës.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Beqiri.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** i parashtroi pyetje ministrit të Brendshëm lidhur me përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve në strukturën e Shërbimit Policor të Kosovës.

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Pyetjet që nuk morën përgjigje në seancën e sotme, ngase nuk premtoi koha (50 minuta), mbeten për të marrë përgjigje në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte si vijon:

Për----- 70;

Kundër----- 0.

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7, 8,9,10,11,12,13,14,15,16 dhe 17.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte, si vijon:

Për----- 71;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3 dhe 4.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte, si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 5.

Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 29.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte, si vijon:

Për----- 60;
Kundër----- 8.
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17 dhe18.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte, si vijon:

Për----- 68;
Kundër----- 1.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën e vendosjes

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për taksën e vendosjes, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për taksën e vendosjes.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 0.

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

10. Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të AKR-së për ndërrimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryetari i informoi deputetët me kërkesën e Grupit Parlamentar të AKR-së, me të cilën ishte kërkuar që anëtari i deritanishëm i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, Arsim Rexhepi, i cili ishte larguar nga ky grup parlamentar, të zëvendësohet me deputetin Heset Cakolli.

Kryetari e hodhi në votim këtë propozim. Rezultati i votimit ishte, si vijon :

Për----- 56;

Kundër----- 3.

Abstenime-----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Deputetit **Heset Cakolli**, nga Grupi Parlamentar i AKR-së, emërohet anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, në vend të deputetit Arsim Rexhepi.

11. Shqyrtimi i propozimit të Grupi Parlamentar i AKR-së për nxjerrjen e Rezolutës kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë

Kryetari informoi deputetët se në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, kemi ardhur në përfundim që në vend të Rezolutës, Kuvendi të dalë me një deklaratë lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të Serbisë në Kosovë.

Kryetari para deputetëve paraqiti këtë

D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet qëndrimin e Presidentit, të Qeverisë dhe të UNMIK-ut lidhur me mbajtjen e këtyre zgjedhjeve në Kosovë.

Kuvendi konsideron se këto zgjedhje dhe rezultatet e tyre janë të papranueshme dhe nuk do të kenë efekt në Kosovë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:30 .

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale